



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 35/2015

Prishtinë, më 27.10.2015, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-I

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa - kryetar, Besim Beqaj, Raif Qela, Sala Berisha-Shala, Fatmir Rexhepi, Blerim Grainca dhe Duda Balje - anëtarë.

Munguan: Visar Ymeri, Sasha Milosavljeviq, Pal Lekaj dhe Enver Hoti - anëtarë.

I ftuar: z. Lutfi Zharku, Ministër i Infrastrukturës .

Pjesëmarrës të tjerë: Xhelil Bekteshi, Valmire Maloku dhe Besnik Hajdari–MI; Lumnije Murati – ZPRK; Burim Ejupi, Dardan Abazi dhe Visar Berisha – INDEP; Lejla Selimi – OSBE; Berat Thaçi - GAP; Fjolla Uka – KDI; Kushtrim Ahmeti - KTV; Sylejman Blaku - “Kosova Sot”; Dukagjin Maliqi - RTV Dukagjini; Blerim Zhegrova-Tribuna Chanel.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 20.10.2015;
3. Raportim i z. Lutfi Zharku, ministër i Ministrisë së Infrastrukturës, për zhvillimet në fushëveprimtarinë e Ministrisë, në realizimin e prioriteteve në aspektin buxhetor për këtë vit dhe vitin e ardhshëm (Infrastruktura rrugore, trafiku, hekurudhat);
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari propozoi që pika e dytë e rendit të ditës, miratimi i procesverbalit të datës 20.10.2015, të zhvendoset si pikë e tretë.

Rendi i ditës u miratua me ndryshimin e propozuar nga z.Mustafa.

2. Raportim i z. Lutfi Zharku, ministër i Ministrisë së Infrastrukturës, për zhvillimet në fushëveprimtarinë e ministrisë, në realizimin e prioriteve në aspektin buxhetor për këtë vit dhe vitin e ardhshëm (Infrastruktura rrugore, trafiku, hekurudhat)

Kryetari, tha se sipas programit të punës, kemi paraparë që si pikë e rendit të ditës të jetë, raportimi i z. Lutfi Zharku, ministër i Ministrisë së Infrastrukturës, për zhvillimet në fushëveprimtarinë e ministrisë, në realizimin e prioritetëve në aspektin buxhetor për këtë vit dhe vitin e ardhshëm, si infrastruktura rrugore, trafiku, hekurudhat, në mënyrë që deputetët dhe Komisioni, të jenë të informuar rreth aktiviteteve të tyre dhe projekteve të ministrisë. Sidomos, sektori i hekurudhave është i një rëndësie të veçantë, pasi që deri më tani, nuk iu ka dhënë ndonjë prioritet. Më pas, ia dha fjalën ministrit.

Lutfi Zharku, ministër i Ministrisë së Infrastrukturës (MI), në ekspozenë e tij para deputetëve, paraqiti prioritetet, projektet dhe zhvillimet në Ministrinë e Infrastrukturës. Ai tha se ministria ka vazhduar në realizimin e projekteve në rikonstruktimin e infrastrukturës ekzistuese, ndërtimin e rrugëve të reja, si dhe bashkëfinancimet me kuvendet komunale. Shumica e projekteve që janë duke u realizuar gjatë këtij viti, kanë qenë të kontraktuara nga viti i kaluar, ndërsa disa do të vazhdojnë edhe në vitin e ardhshëm, qoftë për shkak të kufizimeve buxhetore dhe kontraktuale, qoftë për shkak të joefikasitetit të operatorëve ekonomikë. Në total, këto investime kapin shumën prej 115 milionë euro apo shprehur në mënyrë fizike, flasim për 172 km rrugë, që në formë të ndryshme, janë trajtuar nga ana e ministrisë. Gjatë këtij viti, janë realizuar punë në shumën prej 33 milionë euro. Në këto shifra, nuk është përfshirë projekti madhor, autostrada Prishtinë – Hani i Elezit. Sa i përket rrugëve nacionale, punët kryesisht janë përqendruar në këto projekte: zgjerimi i rrugës Prishtinë-Mitrovicë (segmenti Milloshevë - Lumi i Bardhë), me rreth 9.4 milionë euro, me gjatësi 4.16 km; zgjerimi i rrugës nacionale Prishtinë – Pejë në segmentin Arllat –Kijevë dhe Llozicë-Mleqan, 8.75 km, vlera 15.3 milionë euro; rehabilitim i rrugës N25.3 Shtime – Ferizaj, 10.3 km, vlera 1,544,988 euro; rehabilitimi i rrugës nacionale M25 Ferizaj-Klllokot, 17 km, vlera 728,518 euro; rehabilitimi i rrugës N2 QMI-Hani i Elezit, 51 .1 km, vlera 2,054,451 euro. Në sferën e rrugëve rajonale disa nga projektet kryesore përfshijnë: Zgjerimi i rrugës Komoran-Skënderaj R102, segmenti Klinë e Epërme-Morinë, rreth 12 milionë euro, me gjatësi prej 12.9 km; rehabilitimi i rrugës rajonale R122 Klllokot-Viti –Gërllicë, 15.8 km, vlera 955,092; zgjerimi i rrugës “Brahim Ademi dhe Driton Islami”, në Ferizaj, rreth 3.7

milione euro, me gjatësi 4.57 km; asfaltimi i rrugës nga Suhareka në Ferizaj, përmes Mushtishtit, Budakovës dhe Jezercit, 8.7km, vlera 988,315 euro; ndërtimi i rrugës Orllan –Bervenik, rreth 1.3 milion euro; ndërtimi i rrugës Osojan-Rakosh, rreth 1.2 milion euro; ndërtimi i rrugës rajonale Piranë - Mamushë, 5.7 km, vlera 958,893 euro; rehabilitimi i rrugës rajonale R126 segmenti Pollat – Reçicë - Demë Ahmetaj, 7.44 km, vlera 1,200,743 euro; rikonstruktimi i rrugës Hogosht-Lisockë, në Kamenicë, 7 km, vlera 928,841 euro; ndërtimi i rrugës Çitak-Vitak-Çubrel, 11.4 km, vlera 855,900 euro; ndërtimi i rrugës Abri e Epërme-Tërdevc-Gollubofc, 4.67 km, vlera 810,588 euro; ndërtimi i rrugës Morinë-Rrezallë, 6.2 km, vlera 795,116 euro; ndërtimi i rrugës Deçan-Kozhnjer, 4 km, 1,189,259 euro; asfaltimi i rrugës Dol –Kusar –Goden, 5 km, vlera 520,375 euro; ndërtimi i rrugës Loxhë-Kërstoc-Qollopek, 20 km, vlera 2.5 milionë euro; ndërtimi i rrugës Pejë-Tërstenik, 16 km, vlera 2 milionë euro; ndërtimi i rrugës që lidh autostradën “Ibrahim Rugova” me Prizrenin, përmes Hoqës, rreth 1.1 milion euro, me gjatësi 1.21 km. Në kuadër të programit të bashkëfinancimit me komuna, është punuar në projekte që përfshijnë rrugë në gjatësi prej 81.2 km në shumë prej rreth 7.7 milionë euro. Natyrisht, gjatë tërë vitit është vazhduar edhe me programin e rregullt të mirëmbajtjes verore dhe dimërore të rrugëve nacionale dhe rajonale, bazuar në kontratat kornizë 3 vjeçare. Krahës kësaj, ka vazhduar implementimi i projektit për ndërtimin e autostradës Prishtinë – Hani i Elezit. Siç e dini, para dy ditesh, është inaguruar udhëkryqi më i madhë në rajon që lidh dy rrugët e kombit, autostradat “Ibrahim Rugova” dhe “Arbën Xhaferi”. Punët tjera të vrazhda po kryhen përgjatë segmentit rrugor, deri në fshatin Babush, kurse shtresat e para të asfaltit në gjatësi prej 6.9 km, janë kryer deri te udhëkryqi i Lipjanit. Ministria e Infrastrukturës, ka vazhduar edhe me planifikimin e projekteve të reja që priten të fillojnë gjatë vitit të ardhshëm, qoftë përmes financimit nga buxheti apo përmes huazimit nga institucionet financiare ndërkombëtare. Vazhdimi i autostradës “Ibrahim Rugova”, nga Prishtina deri në Podujevë, po negociohet të kryhet përmes financimit nga BERZH-i. Aktualisht, është duke u kryer plotësimi i studimit të fizibilitetit, i cili do të definojë edhe kategorinë e rrugës, si dhe mënyrën e financimit përmes huazimit dhe grantit nga KE, pasi që është përfshirë në rrjetin bazë të Evropës Juglindore, në përputhje me konkluzionet e takimit të kryeministrave, në kuadër të forumit Ballkani Perëndimor 6, si rrjedhojë e procesit të Berlinit. Projekti i autostradës Prishtinë – Gjilan – Dheu i Bardhë, është në fazën përfundimtare të hartimit të projektit zbatues. Po ashtu, edhe ky projekt parashihet të zbatohet përmes financimit nga ana e BERZH-it, dhe sipas planifikimeve tona, duhet të fillojë në muajt e parë të vitit 2017. Sa i përket projektit të zgjerimit të rrugës nacionale Prishtinë – Pejë, gjegjësisht segmentit Kijevë – Pejë në gjatësi prej 32 km, tanimë pothuajse është kryer plotësim-studimi i fizibilitetit dhe vlerësimi i ndikimit mjedisor dhe social nga ana e BERZH-it, kurse pritet që gjatë këtij viti të aprovohet për financim dhe planifikohet që punët të fillojnë në mesin e vitit të ardhshëm. Po ashtu, gjatë vitit të ardhshëm, pritet të fillojë projekti i ndërtimit të rrugës së re nacionale, Prishtinë - Mitrovicë në segmentin Lumbardh i Vushtrisë, deri në Mitrovicë, në gjatësi prej 27 km. Siç e dini ky, projekt do të financohet nga huamarrja në vlerë prej rreth 50 milionë €, prej Fondit Saudit për Zhvillim, Bankës Islamike dhe Fondit të OPEC-ut për zhvillim. Të gjitha këto marrëveshje, janë ratifikuar nga Kuvendi i Kosovës, vite më parë dhe presim që gjatë muajve korrik-gusht të vitit të ardhshëm, të fillojnë punimet. Projekt tjetër me rëndësi, i cili po përgatitet, është edhe zgjerimi i rrugës Nacionale Besi –Podujevë, në gjatësi prej rreth 20 km. Kur jemi te projektet e

reja që priten të fillojnë gjatë vitit të ardhshëm, ju njoftoj se tanimë kemi marrë konfirmimin zyrtar nga BERZH-i, për financimin e një pakoje të projekteve më të vogla, ku përfshihen zgjerimi i rrugëve hyrëse dhe dalje të Gjilanit, Ferizajt, Prizrenit dhe Suharekës, si dhe rikonstruktimit substancial të rrugës Klllokot – Gjilan, në shumë të përgjithshme prej rreth 30 milion euro. Ne presim që të gjitha procedurat e nevojshme për marrjen e kësaj kredie, të kryhen gjatë këtij viti, në mënyrë që në pranverë të vitit të ardhshëm, të fillohet menjëherë me zbatimin e këtyre projekteve. Në sektorin e hekurudhave, siç e dini, në fillim të tetorit është nënshkruar marrëveshja me BERZH-in, në shumë prej 40 milionë euro, kurse në fillim të dhjetorit, pritet nënshkrimi i marrëveshjes me BIE edhe për 41 milionë të tjera për financimin e rikonstruktimit të hekurudhës, Hani i Elezit – Leshak. Krahas kësaj, do të përfitojmë edhe 80 milionë euro grante nga KE për financimin e këtij projekti. Aktualisht, bashkë me Infrakos-in dhe MF-në, jemi në fazën e kompletimit të njësisë për implementimin e projektit. Në fushën e transportit ka vazhduar kompletimi i infrastrukturës ligjore përmes ndryshimit dhe plotësimit të udhëzimeve administrative, me qëllim kryesor, lehtësimin e licencimit të ndërmarrjeve të angazhuara në transportin e udhëtarëve dhe mallërave, qoftë në transportin e brendshëm apo ndërkombëtar. Po ashtu, ka nismë për lidhjen e marrëveshjeve bilaterale për transport me Luksemburgun, Norvegjinë, Holandën dhe Danimarkën. Në fushën e transportit ajror, gjatë këtij viti, në ANP "Adem Jashari" kanë operuar 25 avio-kompani ajrore, të cilat kanë zhvilluar aktivitetin e trafikut ajror, në baza konkurruese. Deri më tani, janë shqyrtuar 144 kërkesa të avio-kompanive për fluturim "ad-hoc" dhe të njëjtave iu është mundësuar të shfrytëzojnë të drejta të trafikut ajror, në 26 destinacione të udhëtimit, nga Kosova për në vendet e Evropës, me një kapacitet të pasagjerëve në vajtje-ardhje rreth 1.6 milion deri në fund të vitit, e që paraqet rritje të numrit të udhëtarëve mbi 10%, krahasuar me vitin e kaluar. Kur jemi te transporti ajror, ju njoftoj se në projektbuxhetin për vitin 2016, është përfshirë edhe Agjencia për Shërbimet e Navigimit Ajror, e cila deri më tash ka funksionuar si ndërmarrje publike, që paraqet veprimin kyç në zbatimin e Ligjit për shërbimet e navigacionit ajror, të miratuar në Kuvendin e Kosovës në vitin 2013. Në fushën e automjeteve është vazhduar me kontrollimin teknik dhe mbajtjen e provimeve për patentë shoferi. Gjatë 9-mujorit të këtij viti, testin e kontrollit teknik, gjithsej e kanë kryer 218,071 automjete, por që mbetet brengë edhe më tutje, mbikqyrja e kryerjes kualitative të këtij shërbimi, duke marrë parasysh se vetëm 1,338 automjete nuk e kanë kaluar testin e rregullsisë. Testimit për patentë shoferi iu kanë nënshtruar 41,740 kandidatë në pjesën teorike dhe 28,680 kandidatë në pjesën praktike, kurse provimin për shofer e kanë kaluar gjithsej 21,965 kandidatë. Në këtë fushë ka vazhduar edhe ngritja profesionale e shoferëve, instruktorëve, ligjeruesve profesionalë në autoshkolla, si dhe pyetësve. Po ashtu, kanë përfunduar të gjitha përgatitjet për shpalljen e tenderit për testimin elektronik të kandidatëve për shoferë nga pjesa teorike, ku presim që të fillojë implementimin në muajt e parë të vitit të ardhshëm. Në fushën e legjislacionit, Projektligji për siguri në komunikacionin rrugor, është ndarë në tri projektligje: projektligji për patentë shofer, i cili tanimë është në procedurë parlamentare; projektligji për rregullat e komunikacionit rrugor, është përfunduar në ministri; projektligji për automjete, është në fazën përgatitore dhe presim që të miratohet në Qeveri, deri në fund të nëntorit. Krahas kësaj, po punohet në një numër të udhëzimeve administrative, ku deri më tash janë përfunduar 3 udhëzime, 1 është në fazën e miratimit ndërinstitucional, 4 janë në diskutim publik, kurse 5 janë në

fazën e hartimit. Në fund, theksoi se Departamenti i Inspektoratit po vazhdon me inspektime të rregullta në transportin rrugor, infrastrukturë rrugore, qendra të kontrolleve teknike të automjeteve, si dhe në auto shkolla. Gjatë këtij 9-mujori, janë kryer mbi 2,500 inspektime në terren, që kanë rezultuar me mbi 500 inicime në gjykatë për kundërvajtje.

Kryetari, tha se kemi një numër të projekteve të paraqitura në ekspozenë e z. Zhaku, që janë vazhdimësi e punëve në Ministrinë e Infrastrukturës. Por, kthesa e madhe tani, është orientimi nga bashkëfinancimi i këtyre projekteve të infrastrukturës nga donatorët dhe marrja hua e kredive nga bankat ndërkombëtare. I gjithë ky financim është me rëndësi të madhe për zhvillimin ekonomik, pasi që kemi hyrë në një proces të uljes së kostos së buxhetit të shtetit. Pyeti lidhur me hekurudhën Prizren – Milot, pse nuk është e paraparë në projekte të infrastrukturës? Lidhja me hekurudhën me portin e Durrësit, ku lidhen shumë vija detare me shumë shtete, është shumë e rëndësishme dhe strategjike. Andaj, këtë çështje duhet ta aktualizojnë qeveritë dhe ministrinë përkatëse të dy vendeve, që ky projekt të fillojë, pasi që hap shumë korridore ndërkombëtare dhe i shërben zhvillimit ekonomik. Lidhur me aeroportin, presim një raport nga MZHE-ja për zbatimin e kontratës së koncensionimit. Autostrada për Gjilan, ku do të lidhet dhe kah do të shkojë? Po ashtu, tha se keni një front të gjerë të punimeve në infrastrukturën rrugore, andaj duhet të kalohet në fazën e analizimit të buxhetit dhe projektimit të detajuar, para fillimit të ndërtimit të infrastrukturës rrugore. Pra, duhet shmangur modelit projekto-ndërto dhe së pari duhet bërë projektin detal, pastaj të fillohet me ndërtimin e rrugëve. Pyeti lidhur me zgjerimin e rrugës për Podujevë. Është mirë që po bëhen projekte të fizibilitetit në përgjithësi. Po ashtu, pyeti për situatën buxhetore të ministrisë. Si ka shkuar buxheti këtë vit dhe shpenzimet, problemet buxhetore me të cilat ballafaqoheni këtë vit dhe në vitin e ardhshëm në përgjithësi, si dhe a pritni që kufizimet buxhetore të jenë problematike për ministrinë?

Blerim Grainca, Fillimisht, dua të ju falënderoj për informatën dhe raportin tuaj në lidhje me punët dhe investimet që po kryhen nga Ministria e Transportit/Infrastrukturës. Me këtë rast, dëshiroj të shtroj edhe paraqes për diskutim edhe disa çështje që mendoj se janë me rëndësi për ne dhe për ngritjen e performancës. 1. Investimet në infrastrukturën rrugore - Pas ndërtimit me sukses të Autostradës “Ibrahim Rugova” që lidh Prishtinën me Tiranën dhe e cila përfundoi me sukses, neve tani jemi në proces të ndërtimit të Autostradës për Shkup. Të dy këto rrugë kanë rëndësinë e tyre dhe mundësojnë dalje dhe lidhje me portin e Durrësit dhe lidhjen me koridoret tjera, duke bërë Kosovën qendër të rëndësishme. Meqë të dy këto projekte po financohen nga Buxheti i vendit, kjo është dëshmi e potencialit finaciar që kemi. Zoti Ministër, ju folët për mundësitë alternative të financimit të projekteve kapitale, ju rekomandoj që të keni parasysh që gjatë bisedave me Berzh-in, Bankën Europiane për Investime, me Komisionin European, etj. të keni parasysh dhe jeni vigjilent që kreditë e marra mos të ndikojnë në prishjen e balansit që lidhet me borgjin publik të vendit. Ju i dini kufizimet që kemi nga Fondi Monetar Ndërkombëtar. Ekspropirimi i tokave për nevoja të autostradës është një problem i veçantë. Në përgjithësi, çmimi bazë i tokës është ok, por ka shumë vërejtje në mes pronave në afërsi, ku paguhen me standarde dhe tarifa të ndryshme. Duhet të koordinoni më mirë me Ministrinë e Financave këtë fazë të punëve. 2. Hekurudha - Rëndësi të veçantë ka rehabilitimi i linjës egzistuese, por edhe ju duhet të ngritni në nivel

më të lartë edhe koordinimin me Qeverinë e Shqipërisë, për të përfunduar studimin e fizibilitetit për Hekurudhën për Kosovë/Durrës. Edhe për kundër fjalëve dhe nga të gjitha dokumentet e qeverisë në Tiranë dhe në veprimet e tyre duket se ata nuk e kanë prioritet as afatmesëm ndërtimin e kësaj hekurudhe dhe kjo lenë shumë për të dëshiruar. 2. Mirëmbajtja e Rrugëve - Do ishte me rëndësi edhe të analizoni mundësinë e dhënjes me koncesion të mirëmbajtjes së rrugëve dhe futjen e kapitalit privat në këtë sektor, por pse jo edhe në investime strategjike përmes PPP. Unë mund të ju sjell shumë shembuj të praktikave të tilla. 4. Siguria në Rrugë, regjistrimi i Automjeteve dhe Dhënja e patent shoferëve. Edhe për kundër qasjes pozitive dhe optimizmit tuaj për rritjen e kontrollave teknike të automjeteve dhe rritjen e numrit të të rinjve që pajisen me patent shofer, më lejoni të ju rikujtoj se nëse i referohemi statistikave për numrin e të vdekurve në komunikacion, rezulton se kemi një situatë jo të mirë dhe rrugët tona nuk janë të sigurta. Nuk duhet për asnjë moment të amnistojmë faktorin njeri dhe pakujdesinë e shoferëve, por juve duhet të shikoni a kontrollohen si duhet teknikisht automjetet kur regjistrohen dhe a pajisen me dije shoferët e rinj, apo i marrin në rrugë jo legale patent shoferët. Shpresoj që këto rekomandime do të ju ndihmojnë në punët e përditshme dhe realizimin e objektivave.

Besim Beqaj, lidhur me borxhet publike, tha se Ministra e Financave i bën në kuadër të marrëveshjeve me FMN-në dhe për këto kredi, MF e ka filluar procedurën që 3 vite, duke i bërë të gjitha fazat përgatitore për marrjen e kredi-huave nga BERZH-i. Pyeti për zgjerimin e rrugëve rajonale Prishtinë-Pejë dhe Prishtinë-Mitrovicë, pse po ka ngecje të mëdha të punimeve, ku qëndron problemi, te shpronësimi, buxheti apo te kompanitë kontraktuese? Lidhur me zgjerimin e rrugës në drejtim të Mitrovicës, tha se është një kontratë me tri institucione financiare dhe duhet të dihet se a do të shkohet me ta apo të shkëputet kontrata. Segmenti para urës në Kijevë, ka ngecje. Çka po ndodh? Për projektin e daljes, prej Pejës deri në Zahaq, çka po ndodh me këtë segment rrugor?

Fatmir Rexhepi, tha se në ndërtimin e rrugëve është duke u bërë një punë e mirë. Megjithatë, duhet të shtohet dinamika. Në trekëndëshin, Ferizaj – Viti - Gjilan, është bërë rehabilitimi i rrugëve, pasi që në këtë pjesë, deri më tani, nuk ka pasur investime. Pyeti për projektin e autostradës Prishtinë – Gjilan – Dheu i Bardhë, a do të kryhet projekti sivjet? Kah e ka paraparë që të kalojë projekti, traseja në rrugën rajonale ekzistuese apo do të hapet një trase e re? Cilat janë mundësitë buxhetore, si do të financohet ndërtimi i kësaj autostrade?

Raif Qela, iu referuara raportit që ka dhënë ministri Zharku, më 24 shkurt të vitit 2015, ku ka treguar pjesën më të madhe të punimeve që do të realizohen. Z. Qela, parashtroi disa pyetje: ruga për në Gjilan, a do të jetë zgjerim apo autostradë? Lidhur me sigurinë në rrugë, një prej shkaqeve të aksidenteve është zvarritja e projekteve, sidomos në drejtim të Pejës dhe Mitrovicës. Nënkalimet që po mungojnë, në rrugë ndodhin aksidente. Çka është duke ndërmarrë ministria që të ketë nënkalime? Cilësia e rrugëve, në disa vende, është e dobët. Duhet të ketë kontroll më të madh të cilësisë së ndërtimit. Çka keni ndërmarrë për të angazhuar një kompani për të mbikëqyrë cilësinë e punimeve në autostradën në Prishtinë - Han të Elezit? Për rrugën Deçan-Plavë, kur pritet të përfundojë projekti? A ka ndëshkim për operatorët që po vonojnë kryerjen e punimeve në rrugët në

drejtim të Pejës dhe Mitrovicës? Për vitin 2016, a keni paraparë ndonjë projekt për të lidhur rrugën nga Trepça, me disa fshatra të Shalës së Bajgorës (Bistricë, Cerajë e Koshtovë), që janë në brez të kufirit me Serbinë?

Ministri Zharku, iu përgjigj pyetjeve të parashtruara. Për buxhetin që i ndahet MI-së, tha se kanë problem buxhetor, sidomos në kërkesat e komunave që i kanë për bashkëfinancim, që janë shuma të mëdha të mjeteve financiare dhe që nuk mund t'i mbulojnë të gjitha kërkesat. Për zgjerimin e rrugëve rajonale dhe autostradat, pjesa më e madhe e këtyre projekteve është vendosur të realizohet me investimet që janë paraparë në marrëveshje me BERZH-in. Lidhur me hekurudhën Prizren – Milot, tha se Kosova ka shprehur gatishmëri që të investojë në këtë projekt, por nga ana e Shqipërisë është vlerësuar se për ta është një kosto shumë e lartë financiare, pasi që ka një gjatësi të madhe dhe kushton afërsisht 1 miliard euro. Për projektin e autostradës Prishtinë – Gjiilan – Dheu i Bardhë, tha se janë dy variante, njëri të kalojë në rrugën rajonale ekzistuese dhe tjetri të hapet një trase e re, por që ende Komisioni Ndërministror nuk ka vendosur se në cilin variant të shkohet. Për dhënien e autostradave me koncesion, tha se nuk e kanë shqyrtuar ende këtë ide, pasi që nuk ka lidhje të gjata mes korridoreve. Për marrëveshjet që i kemi me FMN-në, tha se janë projekte huamarrëse, në bazë të buxhetit. Për shpronësimet, tha se janë të përfshira 3 ministri: Ministra e Financave; Ministra e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministra e Infrastrukturës. Në kuadër të këtyre ministrive, është një komision për pagesa dhe është çështje buxhetore që nuk e cakton MI. Për sigurinë në komunikacion, tha se është një brengë e madhe edhe për neve, por MI, në bazë të kompetencave, e ka hartuar një strategji për sigurinë në komunikacion, por në bazë të raporteve të policisë, në shumë aksidente, fajtori është faktori njeri. Për ngecjet e zgjerimit të rrugëve rajonale, tha se ka probleme me shpronësim në rrugën Prishtinë – Pejë. Kjo është arsyeja e ngecjes, por edhe e kemi rikontraktuar projektin për Urën e Llozicës dhe e kemi paditur kontraktorin, por për çudi, çdo kontest, ministria po e humb në gjykata. Për segmentin e rrugës në dalje nga Peja deri në Zahaq, tha se ka pasur një problem me projektin e ndërtimit të rrugës, ndërsa Komuna e Pejës e ka hartuar një projekt të ri dhe pritet të fillojë zgjerimi i këtij segmenti rrugor. Ndërsa për rrugën Prishtinë – Mitrovicë, ka pasur problem lidhur me prokurimin publik, pasi që financimi është bërë në marrëveshje me Bankën Islamike. Tani, këto probleme janë tejkaluar dhe punimet do të vazhdojnë. Për nënkalimet, tha se ka probleme me shpronësime, sidomos nëpër vendbanimet në komuna, pas që komunat duhet të bëjnë shpronësimin dhe nuk kanë mjete financiare. Për cilësinë e ndërtimit të rrugëve, tha se MI-ja e ka një laborator që ka punuar gjatë tërë vitit, për të kontrolluar cilësinë e ndërtimit të rrugëve, ndërsa për autostradat, kemi kontraktuar me një kompani për mbikëqyrjen e cilësisë së rrugëve. Projekti i rrugës Deçan-Plavë është një projekt i kushtueshëm. Jemi pajtuar me kryetarin e Komunës së Deçanit, që të shkohet me projektin faza – faza, në segmente. Për rrugën prej Trepçës deri në Shalë të Bajgorës, nuk kemi të planifikuar ndonjë investim, pasi që buxheti i MI-së për bashkëfinancim me komuna, është shumë i limituar.

Raif Qela, pasi që shpeshherë ministria po i humb kontestet në raport me operatorët, atëherë kontratat duhet të jenë më të mira, duhet të ceken më shumë detajet dhe obligimet që duhet t'i kenë me operatorët. Pyeti për zgjerimin e rrugës Prishtinë–Mitrovicë, që po ndërtohet, se a do të kalojë ky zgjerim i rrugës nëpër qytetin e Vushtrrisë. Po ashtu,

sugjeroi që kur të fillojë kjo rrugë, të kalojë nëpër një trase të re, pasi që qyteti mund të ngarkohet shumë nga komunikacioni. Gjatë ndërtimit të rrugëve, në një pjesë të madhe, nuk po ndërtohen rrugë alternative, derisa të ndërtohet rruga. Pse nuk po ndërtohen rrugë alternative?

Blerim Grainca, pyeti për rrugën Carralevë - Shtime - Ferizaj, se a është në projekt ndërtimi i kësaj rruge. Sa është vlera e mjeteve financiare të MI-së për investimet në Komunën e Ferizajt?

Duda Balje, pyeti: a është në projekt të MI-së ndërtimi i rrugës në Komunën e Dragashit, konkretisht në fshatin Restelicë, që lidhet me Maqedoninë?

Sala Berisha-Shala, e përgëzoi ministrin Zharku për punët që janë duke u bërë në infrastrukturën rrugore, në gjithë vendin. Pyeti për zvarritjet e punëve që po ndodhin nga disa kompani. Nganjëherë deklarohen se nuk po iu bëhen pagesat me kohë. A ka raste kur MI-ja nuk i ka kryer obligimet ndaj operatorëve? A ka padi ndaj ministrisë për raste të tilla?

Fatmir Rexhepi, pyeti: çka është në pyetje për rrugën Mramorit, pse nuk po tejkalohet kjo pengesë në këtë rrugë? Po ashtu, i sugjeroi ministrit Zharku, që të paraqitën në publik dhe media të gjitha punët që po i bën MI-ja, pasi që është duke u bërë një punë e madhe, në të mirë të qytetarëve dhe të vendit, por nuk po pasqyrohet sa duhet.

Ministri iu përgjigj pyetjeve të parashtruara. Shumica e rasteve që i humb ministria, ka të bëjë me hartimin e projektit. Kemi raste kur dalin më shumë punë se ato të parapara. Ka raste edhe kur ne kemi obligime ndaj operatorëve, për arsye që t'i shmangemi kontesteve gjyqësore, tentojmë që me marrëveshje, t'i zgjidhim kontestet. Për rrugën Prishtinë – Mitrovicë, tha se do të kalojë nëpër një trase të re dhe do t'i shmangemi rrugës ekzistuese që kalon nëpër qytetin e Vushtrisë. Për rrugët alternative, tha se është problemi, për shkak të shpronësimit dhe kostos së lartë. Për rrugën Carralevë – Shtime– Ferizaj, tha se në afatin e mesëm, nuk parashihet që të jetë në projekt. Për rrugën e fshatit Restelicë, që lidhet me Maqedoninë, tha se kjo rrugë do të jetë në kuadër të bashkëfinancimet me Komunën e Dragashit.

Muhamet Mustafa, tha se kemi pasur një diskutim shumë përmbajtësor dhe kemi rezultate të dukshme nga Ministria e Infrastrukturës. Qeveria dhe Kuvendi duhet t'i prezantojnë punët e bëra në opinionin publik, të shikohet se a ka rezultate dhe lëvizje në drejtim të progresit dhe zhvillimit ekonomik. Autostrada, siç u tha, nuk e ka qarkullimin e parashikuar, derisa nuk lidhet me korridore panevropiane. Për hekurudhën Prizren - Milot, tha se këtë çështje duhet ta sensibilizojmë edhe ne si Komision, në bashkëpunim me Komisionin homolog nga Shqipëria, sepse në qoftë se nuk do të kemi lidhje me autostradat tona në korridore evropiane, vështirë se do të mund të ketë edhe zhvillim ekonomik. Andaj, duhet të konkurrohet me projekte për hekurudhat, edhe në insitucionet e Bashkimit Evropian, në mënyrë që të kemi një zhvillim ekonomik.

Pas debatit, Komisioni, njëzëri, nxori këto

K o n k l u z i o n e:

- 1. Komisioni dhe Ministria të vazhdojnë bashkëpunimin, në të mirë të zhvillimit të infrastrukturës rrugore, hekurudhore dhe trafikut në përgjithësi.*
- 2. Ministria të angazhohet në adresimin e shqetësimeve të ngritura nga anëtarët e Komisionit.*

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 20.10.2015

Kryetari, kërkoi nga deputetët që nëse kanë ndonjë vërejtje në procesverbal, le t'i adresojnë sot ose t'i dërgojnë te stafi i Komisionit.

Sala Berisha-Shala, tha se ka një vërejtje, të cilën do t'ia përcjellë stafit të Komisionit, me shkrim.

Procesverbali i mbledhjes së datës 20.10.2015, u miratua duke përfshirë vërejtjen e deputetes, Sala Berisha- Shala.

4. Të ndryshme

Çështje vijuese

- Kryetari njoftoi anëtarët e Komisionit për dëgjimin publik, që do të organizohet nesër, më 28.10.2015, lidhur me Projektligjin për themelimin e fondit kosovar për garanci kreditore dhe i ftoi të marrin pjesë në këtë dëgjim.
- Kryetari njoftoi anëtarët e Komisionit se do të ketë një takim me ambasadorin e Hungarisë, me të cilin do të shihen mundësitë e bashkëpunimit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:45.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa